



### III

Dhënia në shrytëzim e pronave të paluajtshme të cekur në pikën II , bëhet me kompenzim

### IV

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë , të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shrytëzuesit të pronave të paluajtshme të Komunës

### V

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Planifikim Urban, Pronë dhe Kadastër, Drejtorati për Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspektion.

### VI

Obligohet Drejtorata e Planifikimit Urban , Kadastër dhe Pronë që pas përfundimit të zbatimit të procedurave të dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës të regjistrojnë në librat kadastral si prona të dhëna në shfrytëzim për periudhë afatgjatë.

### VII

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokollit të MPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

#### **Kuvendi i Komunës së Obiliqit**

Nr. I- 55 - , më 23 Mars 2021

T'i dërgohet

- Kryetarit
- Kryesuesit
- MPL
- DPUKP
- DMM
- DEZHF
- DI
- Palës
- Anëtarëve të Kuvendit
- Arkivit



**Kryesuesi i Kuvendit Komunal**

**Burim Gërguri**



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government

Për:	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MPL-së
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit
Lloji i aktit:	<input type="checkbox"/> Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. I - 12 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë - "N.T.P.EB"
I miratuar më datë: 29.01.2021
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 05.02.2021

12. pm -  
4 km

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. I - 12 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë - "N.T.P EBF"	<p>Vendim përfundimtar i Kuvendit të Komunës Nr. I - 12 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës së Obiliqit në zonën kadastrale në Llazarevë "N.T.P EBF" është në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës përkatësisht me pikat 6.2, 6.4 dhe 6.6 të paragrafit 6 të nënit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, ku ceket se:</p> <p><i>"Pas negociimit të ofertës, kryetari i komunës i propozon kuvendit të komunës të miratoj vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, duke i bashkangjitur dokumentet përcjellëse, si:</i></p> <p>6.2 <i>Ofertën e negociuar, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;</i></p> <p>6.4 <i>Projekti i paraqitur nga investitori dhe plani dinamik i realizimit të investimit;</i></p> <p>6.6 <i>Certifikatën e regjistrimit të biznesit, vërtetim që nuk ka obligime tatimore, qarkullimi bankar për vitin paraprak.</i></p> <p>Në rastin konkret Vendimit i mungon oferta e negociuar, plani dinamik i realizimit të investimit nga investitori, si dhe qarkullimi bankar për vitin paraprak.</p>

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Obiliqit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.